



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit(Gllogoc)**

Zyra e Kuvendit të Komunës
Nr. _____ dt. _____ 2014



Nga :Kryesuesi i Kuvendit të Komunës- Z. Naim Bazaj



Për: Kryetarin e Komunës z.Nexhat Demakun

LËNDA:Dërgimi i akteve te miratuara nga Kuvendi i Komunës se Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt:24.09.2014

- 1.Vendimi I buxhetit të komunës për vitin 2015 dhe parashikimi I buxhetit 2016-2017
- 2.Vendimi për financimin e projektit RFBSH "Drenasi"2014
- 3.Vendimi për dhënjën e prones së paluajtshme Komunale në shfrytëzim afatgjatë

Më dt:29.09.2014

Drenas



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	29	29	2014
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
12	400-42240		



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit

VENDIM
I BUXHETIN TË KOMUNËS PËR VITIN 2015
DHE PARASHIKIMI I BUXHETIT 2016-2017

Drenas, shtator 2014

Në bazë të nenit 12, nenit 40 pika 40.2, nën b. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në bazë të nenit 34. pika 34.6 nën (b), të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën 24.09. 2014 miratoi këtë;

VENDIM
PËR BUXHETIN E KOMUNËS PËR VITIN 2015 DHE PARASHIKIMIN E
BUXHETIT 2016-2017

Neni 1.

Më këtë vendim, miratohet Buxheti i Komunës së Drenasit, për vitin 2015 si dhe parashikimi i buxhetit për vitin 2016-2017.

Neni 2.

Buxheti i komunës miratohet sipas viteve dhe sipas këtyre shumave:

- për vitin 2015 shuma prej: 12,118,623 €
- për vitin 2016 shuma prej: 11,953,096 €
- për vitin 2017 shuma prej: 12,144,053 €

Neni 3.

Buxheti i miratur dhe i përmendur në nenin 2 të këtij vendimi sipas viteve do të financohet nga:

- Granti i Qeverisë dhe nga
- të hyrave vetanake.

Të hyrat nga Granti i Qeverisë për Buxhetin e Komunës do të realizohen:

- në vitin 2015-Granti i Përgjithshëm:4,757,815€,Granti për Arsim:4,776,086€ dhe Granti I Shëndetësisë 1,383,848€,
- në vitin 2016-Granti i Përgjithshëm:4,453,275 €,Granti për Arsim:4,823,735 € dhe Granti I Shëndetësisë 1,444,186 €,
- në vitin 2017-Granti i Përgjithshëm:4,525,649 €,Granti për Arsim:4,846,936 € dhe Granti I Shëndetësisë 1,477,068 €.

Të hyrat vetanake për Buxhetin e Komunës do të realizohen:

- në vitin 2015 nga administrata komunale:1,095,874€, nga shëndetësia:48,000€ dhe nga arsimi:57,000€
- në vitin 2016 nga administrata komunale:1,131,900 €, nga shëndetësia:51,000 € dhe nga arsimi:49,000 €

-në vitin 2017 nga administrata komunale:1,187,400 €, nga shëndetësia:55,000 € dhe nga arsimi:52,000€.

Neni 4

Komuna gjatë viteve në vijim, mund të realizoi mjete edhe nga donatorët dhe participimi i qytetarëve.

Neni 5.

Shpenzimet për vitet 2015-2017 aprovohen për 14 programe-nënprograme në nivel komunal sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve dhe sipas viteve.

Neni 6.

Pagat dhe mëditjtë e përcaktuara më këtë vendim janë në shumë prej:7,420,000€ dhe do të shpenzohen për pagimin e stafit në tri Sektoret e Komunës.Në Sektorët e Komunës me planifikimin e këtij Buxheti janë të lejuar 1312 punëtorë dhe ky numër është i përcaktuar me Qarkorën Buxhetor të MF-it.

Pagat e aprovuar të stafit më këtë vendim nuk mund të rriten gjatë vitit fiskal me përjashtim të rritjes së lejuar me Vendim të Qeverisë së Kosovës.

Neni 7.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime për vitin 2015 janë planifikuar në shumë prej:827,829 € dhe këto shpenzime do të shpenzohen për 14 programe buxhetore komunale sipas projekteve të ofruara nga ana e programeve dhe nevojave tjera që do të paraqitën gjatë vitit fiskal.

Neni 8.

Shpenzimet e Shërbimeve Komunale në vitin 2015 do të jenë në shumë prej:194,300€ për të gjitha programet.

Neni 9.

Mjetët për Subvencione-transfere të aprovuara në shumë prej:257,957 € do të shpenzohen për projektet të cilat do të aprovohen nga ana e Kuvendit të Komunës, në bazë të kriterëve të përcaktuar nga Departamenti I Thesarit-MF

Neni 10.

Shpenzimet për Investime Kapitale aprovohen si vijon:

-në vitin 2015 në shumë prej:3,418,537 €

-në vitin 2016 në shumë prej:3,034,455 €

-në vitin 2017 në shumë prej:3,225,410 €

Neni 11.

Pjesë përbërse e këtij Vendimi janë Tabelat Buxhetore dhe Tabelat për Investime Kapitale për vitin 2015-2017.

Neni 12.

Ky Vendim i Buxhetit hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës dhe do të aplikohet nga 1.janari 2015

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Bazaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Zyra e Kuvendit të Komunës



Nr. 465-42247 dt 29.09 2014

Në bazë të nenit 12 pika d, nenit 40 pika b, dhe c, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 si dhe në bazë të nenit 34.6 nën b. dhe c. Të Statutit të Komunës së Drenasit, rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve si dhe vendimit për buxhet të aprovuar për vitin 2014 Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogocit) në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur me datën 24.09.2014 aprovoi këtë:

V E N D I M

Për financimin e projektit RFBSH „Drenasi 2014”

Neni 1.

Me këtë vendim kerkohet mbështetja financiare për projektin e RFBSH „Drenasi 2014” Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për organizimin e RFBSH Drenasi 2014

Neni 2.

Projekti i RFBSH „Drenasi 2014” përkrahet me shumën prej 10.000€ mjete të cilat do të shfrytezohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2014

Neni 3.

Financimi – Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS nga kategoria ekonomike e shpenzimeve ,subvencioneve dhe transfereve ,kodi ekonomik 21/85001/200.

Neni 4.

Mjetet financiare barten ne konton e RFBSH „Drenasi 2014”. Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2. të ketij vendimi të përciellë implementimin e projektit ,duke kërkuar nga RFBSH Drenasi 2014 që të bëj raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Zyra e Kuvendit të Komunës



Nr. 465-42246 dt 29.09. 2014

Në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 3 pika 1.4 si dhe nenit 6 të Ligjit për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së paluajtshme të Komunës Ligjit Nr. 04/L-144, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të komunës dhe kerkese për ryshqyrtim të MAPL-së Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogocit) në mbledhjen e mbajtur me dt.24.09.2014 miratoi këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN E PRONES SË PALUAJTSHME KOMUNALE NË SHFRYTËZIM AFATGJATË

Neni 1

Aprovohet vendimi i komisionit për ndarjen e parcelave të dhëna në shfrytëzim për periudhën afatgjatë sipas ligjit Nr.04/L-144 për dhënjën e tokave në shfrytëzim.

Neni 2

Ndarja e parcelave ka qenë në përputhje me ligjin për dhënjën e tokave në shfrytëzim Nr. 04/L-144 dhe kriteret e konkursit të shpallur në bazë të numrit të punëtorve, vlerës investive, çmimit të ofruar, dhe veprimtarisë që zhvillon.

Neni 3

Jipet në shfrytëzim Prona e paluajtshme e Komunës me sa vijon:


- Emri i përfituesit „Kodra” shpk
- Zona Katastrale 295/1 Sankoc, më kultur kullos kl.V në vendin e quajtur Golesh në sipërfaqe prej 5 h ,
- Afati për dhënjën në shfrytëzim të kësaj prone është 40 vite
- Veprimtaria që do të zhvillojë kjo kompani është nxjerrja dhe përpunimi i gurit
- Vlera investive1,045,500.00 €
- Numri i punëtorve 63 vende pune

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit nga Kuvendi i Komunes dhe vlersimi i MAPL-së



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Naim Bazaj